



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: TUBT

Programi: Shkenca e ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Krenare Abazi-Maloku me titull: **“Analizat fiziko-kimike të lëngjeve të frutave dhe pijeve energjike të prodhuesit vendor RELAX për periudhen 2020-2021”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 15 deri me datë 22.07.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Asoc. Xhavit Ramadani, kryetar
2. Prof. dr. ass. Rreze Gecaj mentor
3. Prof. dr.asoc. Alltane Kryeziu anëtarë

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. ass. Rreze Gecaj, përmes e-mail adresës rreze.gecay@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI - TEKNOLOGJI USHQIMORE ME BIOTEKNOLOGJI

PROGRAMI - SHKENCA E USHQIMIT



PUNIM DIPLOME

**“ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE TË LËNGJEVE TË FRUTAVE DHE PIJEVE
ENERGJIKE TË PRODHUESIT VENDOR RELAX PËR PERIUDHEN 2020-2021”**

Mentor:

Prof.Asst.Dr. Rreze Gecaj

Kandidatja:

BSc. Krenare Abazi-Maloku

Qershor, 2024

ABSTRAKT

Në këtë punim diplome Msc është paraqitur pjesa e punës hulumtuese në aspektin laboratik të analizave fiziko – kimike të llojev të ndryshme të lëngjeve dhe pijeve energjike. Punimi shqyrton dhe analizon aspektin teorik dhe prodhimin e lëngjeve dhe pijeve energjike, llojet e lëngjeve, karakteristikat e tyre, legjislacionin lidhur me lëngjet si dhe sigurinë ushqimore. Qëllimi i këtijë punimi hulumtues ka qenë hulumtimi i përmbajtjes fiziko-kimike të lëngjeve të pemëve dhe disa llojeve të pijeve energjike me origjinë vendore të prodhuesit FRUTEX. Në punim përmes metodave hulumtuese të analizës, sintezës, metodës induktive dhe deduktive si metodës komperative arrihet deri te qëllimi hulumtues i punimit. Në periudhën hulumtuese janë marrë gjithësej 36 lloje të lëngjeve dhe pijeve energjike, mostra të lëngjeve dhe pijeve energjike te cilat janë marrë një herë në muaj dhe janë analizuar në periudhë 2 vjeçare.

Mostrat janë analizuar në përbërjen fiziko-kimike (pH, aciditeti, pesha specifike, sheqernat), komponimet fenolike dhe antioksidantet. Gjithashtu, do të bëhet krahasimi ne mes të lëngjeve të koncentruara dhe lëngjeve 100%. Analizimi i mostrave është bërë me metoda standare në laboratorin e kompanisë farmaceutike TREP HARM. Duke i'u referuar legjislacionit të Republikës së Kosovës lidhur me lëngjet e pemëve dhe vlerave referente atëherë vijmë në përfundim se parametrat e analizave të kryera janë brenda limiteve për përdorim: vlera e pH sillet nga 2.41-4.03, vlera e aciditeti 2.10g/lit deri 9.84g/lit, sheqeri 8.91% deri 16.08% dhe lëngu i rrushit, lëngu i qershisë dhe lëngu i dredhzës kanë veti më të larta antioksiduese. Në fund të gjeturat e hulumtimit do tju shërbejnë prodhuesve vendor të lëngjeve dhe pijeve energjike, teknologëve, laborantëve ushqimorë si dhe të interesuereve të tjerë në fushën përkatëse.

Fjalët kyçe: Lëngjet e pemëve, pijet energjike, analizat fiziko-kimike, mostrat, laborator.